



alGOVrithms 2.0

POLICY RECOMMENDATIONS

Automated Decision Making in
Czechia, Hungary, Kosovo,
North Macedonia, and Poland



alGOVrithms 2.0: Policy Recommendations

Autorët:

Michal Škop, Kohovolit.eu – Republika Çeke

Vincze, Orsolya, K-Monitor – Hungari

Art Alishani, Open Data Kosovo - Kosovë

Goce Arsovski, Metamorphosis Foundation - Maqedoni e Veriut

Krzysztof Izdebski, ePaństwo Foundation – Poloni

Edituar nga:

Art Alishani, Open Data Kosovo- Kosovë

Krzysztof Izdebski, ePaństwo Foundation- Poloni

Kordinatore e Hulumtimit:

Dafina Olluri, Open Data Kosovo - Kosovë

Viti: Mars, 2021

• **Visegrad Fund**

The project is co-financed by the Governments of Czechia, Hungary, Poland and Slovakia through Visegrad Grants from Internations Visegrad Fund. The mission of the fund is to advance ideas for sustainable regional cooperation in Central Europe.

PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE

Edicioni i dytë i "alGOVrithms. "The State of Play" hedh një vështrim të thellë në përdorimin e teknologjive për automatizim të vendimmarrjes në marrëdhëniet qeveri-qytetarë në Çeki, Hungari, Kosovë, Maqedoninë e Veriut dhe Poloni. Hulumtimet e bëra kanë ekzaminuar ekzistencën e kornizave përkatëse ligjore, praktikave dhe krijimit, zbatimit dhe përdorimit të proceseve të Automatizimit të Vendimmarrjes (AV) në nivele të ndryshme të qeverisjes, duke u përqendruar në transparencën, llogaridhënien (përgjegjësinë) e tyre dhe rreziqet e mundshme të diskriminimit. Gjatë këtij hulumtimi, autorët e këtij studimi gjithashtu janë fokusuar në kuptimin se si alGOVrithms (termi i krijuar nga ekipi hulumtues për të përshkruar sistemet AV të përdorura nga autoritetet qendrore dhe lokale) janë duke u prokuruar dhe kush është i përfshirë në procesin e zbatimit të tyre. Shembujt e alGOVrithms të paraqitura në raport janë renditur sipas qëllimit të përdorimit të tyre. Ne kemi identifikuar që këto mjete përdoren për mbështetjen e proceve të alokimit të gjyqëtarëve dhe zyrtarëve të tjerë publik; për të zbuluar keq menaxhime dhe keqpërdorime të fondeve publike; për të lehtësuar proceset administrative, të prokurimit publik dhe shpërndarjes së fondeve të ndryshme në skema sociale. Ne gjithashtu kemi identifikuar shembuj shembuj të alGOVrithms të dizajnuar posaçërisht për t'iu përgjigjur sfidave të lidhura me pandeminë COVID-19. Ndër të tjera, lexuesit gjithashtu mund të gjejnë përshkrim të teknologjive që përdoren për të mbështetur autoritetet publike në mbikëqyrjen e respektimit të masave të karantinës, mbikëqyrjen e shpenzimeve të ndihmave të ndryshme shtetërore, apo zbulimin e rreziqeve të përhapjes së kontaminimit.

Sikurse edhe në vitin 2019, ky studim nuk ka identifikuar ekzistencën e kornizave gjithëpërfshirëse ligjore që rregullojnë proceset e ndryshme të zhvillimit dhe përdorimit të alGOVrithm-ëve dhe transparencën e këtyre të fundit. Në përgjithësi, ne nuk kemi hasur në praktika të

përfshirjes së shoqërisë civile, akademisë apo grupeve të tjera të ekspertëve në procesin e përpilimit të politikave dhe rregulloreve ligjore, si dhe të punojmë në zhvillimin e zgjedhjeve të pranueshme teknologjike. Njësoj sikurse gjatë viteve të mëparshme, ne kemi hasur në vështirësi të ndryshme në lidhje me mbledhjen e informacionit për alGOVrithm-a. Kjo për shkak të mungesës së përgjithshme të standardeve të transparencës, dukuri kjo e cila është veçanërisht e përhapur në rastet e aplikimit të teknologjisë informative në sektorin publik.

Ne gjithashtu kemi identifikuar një problem domethënës, që është mungesa e kompetencave të zyrtarëve publik për të menaxhuar dhe mbikëqyrur përdorimin e alGOVrithm-ëve. Shumë shpesh atyre u duhet të mbështeten në ekspertizën që ofrohet nga organizata të jashtme dhe gjithashtu të përballen me mungesën e përgjive gjithëpërfshirëse që lehtësojnë zvogëlimin e ndikimit negativ të gjeneruar nga programe të AV. Kjo nuk do të thotë që autoritetet janë plotësisht indiferente ndaj këtyre zhvillimeve. Disa vende kanë filluar të punojnë në përgatitjen e strategjive mjaft komplekse për zhvillim të Intelegjencës Artificiale, në të cilat po sinjalizojnë edhe nevojën e përgatitjes së kornizave rregulative, udhëzimeve etike dhe mekanizmave konkrete që lidhen me Vlerësimin e Ndikimit Algoritmik. Përgjatë këtyre dokumenteve, ne mund të shohim premtime të ndryshme që lidhen me krijimin e organeve të reja ku përfshihen edhe palët e tjera të interesuara, të cilët do të mbikëqyrin procesin e zbatimit të AV-ve dhe mekanizmave të tjerë që do të rrisin transparencën dhe llogaridhënien e alGOVrithms. Mirëpo, edhe shumë punë të tjera mbetet të kryhen nga qeveritë e vendeve që kanë qenë pjesë e këtij hulumtimi. Gjithashtu, deritash kemi parë pak gatishmëri nga zyrtarët publik për të krijuar strategji të ndryshme për alGOVrithmat ekzistues, të cilët ende nuk përdorin Intelegjencë Artificiale, mirëpo kanë rrol të rëndësishëm në të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve.

Për këtë arsye, ne nxisim qeveritë që të marrin parasyshë sygjerimet dhe të ndjekin rekomandimet e këtij hulumtimi:

1

Të krijohen organe rregullatore qeveritare që fokusohen në mbikëqyrjen e zhvillimit, zbatimit dhe përdorimit të alGOVrithms;

2

Të trajnohen nëpunësit civil me aftësitë e nevojshme për të monitoruar dhe audituar alGOVrithms;

3

Të përgatiten kornizat e nevojshme ligjore që lidhen me zhvillimin e alGOVritmave të besueshëm dhe transparent;

4

Të krijohet korniza e nevojshme ligjore dhe të stimulohet shoqëria civile dhe akademia për t'u angazhuar në monitorimin dhe rregullimin e alGOVritmave;

5

Të organizohen debate publike ne mes të ligjvënësve, shoqërisë civile, bizneseve dhe qytetarëve për të krijuar ligje që garantojnë respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë, të drejtave të njeriut dhe demokracisë;

6

Të krijohet një grup kombëtar i ekspertëve të alGOVritmave dhe Intelegjencës Artificiale, të përbërë nga politikbërësit, shoqëria civile, bizneset dhe akademia. Ky grup do të shërbej si trup këshillues për organet qeveritare që implementojnë teknologji të tilla;

7

Të nxitet ndarja dhe shkëmbimi i praktikave të mira që lidhet me përdorimin e përgjegjshëm të alGOVrit-mave nga agjencitë qeveritare;

8

Të zhvillohen standarde kombëtare për prokurim, mbikëqyrje dhe auditim të alGOVritmave.

KONKLuzionet

Nuk ka dyshim se numri i alGOVritmave do të rritet konsiderueshëm në të ardhmen. Këto teknologji luajn një rrol të jashtëzakonshëm në automatizimin e proceseve të ndryshme administrative, mbështetjen e vendimmarrjes publike, rritjen e efikasitetit të brendshëm dhe përmisimin e ofrimit të shërbimeve publike. Megjithatë, ky studim thekson nevojën për një vëmendje të shtuar në mënyrën se si hartohen, zhvillohen, miratohen dhe përdoren alGOVritmat nga organizatat e sektorit publik. Natyra e tyre e dyfishtë u bë e dukshme edhe gjatë këtij studimi. Në vende të ndryshme, alGOVritmat e ngjashëm mund të përdoren për qëllime të kundërta dhe kontradiktore. Për këtë arsye, ne theksojmë nevojën për të shtuar numrin e përpjekjeve serioze që kanë të bëjnë me përmisimin e të kuptuarit të këtyre teknologjive nga menaxherët publik, shoqëria civile, bizneset dhe qytetarët. Kjo për shkak se gjendja aktuale e njohurive rreth alGOVritmave mbetet e pakjartë dhe e kufizuar në organizatat dhe departamentet që kanë zhvilluar dhe përdorin këto teknologji. Ky studim eksploron një listë të pyetjeve në lidhje me identifikimin dhe zbatimin e alGOVritmave nga organizatat publike në Hungari, Çeki, Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe Poloni. Prandaj, ne identifikuam gjashtë kategori të gjera, në të cilat alGOVrithms ekzistuese mund të grupohen:

1. alGOVritmat e alokimit,
2. alGOVritmat për zbulimin e mashtrimit
3. alGOVritmat e karantinimit në shtëpi (Covid-19)
4. alGOVritmat e Monitorimit Inteligent/ Mbikëqyrjes
5. alGOVritmat Këshillimit Profesional dhe Karrierës
6. Rastet e tjera të alGOVritmave.

Diferencat në numrin, shpejtësinë dhe nivelin e zhvillimit në fushën e alGOVritmave janë të dukshme në vendet që janë pjesë e këtij studimi. Megjithatë ka shumë faktorë që luajnë rrol në këtë kontekst, ne sygjerojmë se ndryshimet e tilla gjithashtu pasqyrojnë gjendjen e përgjithshme të dixhitalizimit në vend. alGOVritmat ekzistues kryesisht implementohen për të adresuar probleme

specifike (d.m.th. rritjen e korrupsionit, ngarkesat e mëdha të punës etj.), për të përmisuar efikasitetin e brendshëm, për të përmisuar cilësinë e shërbimeve publike dhe për të mbështetur automatizimin e proceseve të ndryshme administrative dhe shërbimeve publike. Gjithashtu, në vende dhe organizata të ndryshme, këto teknologji etiketohen me emra të ndryshëm- d.m.th., 'softuer', 'softuer automatizimi', 'sisteme të informacionit' etj.

Ky studim gjithashtu identifikon disa iniciativa për rregullimin e alGOVrithms. Duke pasur parasysh numrin e çështjeve etike dhe politike që ndikohen nga këto teknologji, ne sugjerojmë që praktikrat e ngjashme duhet të rriten dhe të ndiqen gjithashtu nga të gjitha vendet në këtë raport. Meqenëse rregullimi i alGOVrithms kërkon një kuptim të gjerë të ndikimit të këtyre teknologjive në fusha të ndryshme, është mëse e nevojshme që rregullatorët të fillojnë zgjerimin e kapaciteteve të tyre dhe të anazhojnë edhe akterë nga sektorët tjerë- d.m.th., të përfshijnë shoqërinë civile, akademinë, bizneset dhe qytetarët. Shumë nga shqetësimet në lidhje me alGOVritma lidhen gjithashtu me mënyrën e zhvillimit dhe kush qëndron prapa këtyre teknologjive. Gjatë gjithë këtij studimi, ne kemi identifikuar tre praktika dominante: 1) alGOVritmat janë zhvilluar përbrenda organizatave publike, 2) zhvillimi i alGOVritmave i'u është dhënë firmave të jashtme, 3) alGOVritmat janë zhvilluar nëpërmjet një qasje të përzier (d.m.th., zhvilluesit nga të dy palët kanë bashkëpunuar, zhvilluesit nga firma private janë vendosur në mjediset e organizatës publike, etj.). Si përfundim, ne kemi identifikuar edhe një tendencë të përbashkët për të kontrolluar saktësinë dhe drejtësinë e alGOVritmave nga organizatat publike. Megjithatë, kjo rrallë herë bëhet në mënyrë sistematike dhe të rregullar. Për këtë arsye, në i'u bëjmë thirrje institucioneve publike që të zhvillojnë standarde dhe udhëzime të njohura ndërkombëtarisht se si duhet të kontrollohen dhe auditohen alGOVritmat, në mënyrë që të sigurojmë një trajtim të barabartë dhe të drejtë për të gjithë.

RRUGA PARA NESH: REKOMANDIME NË LIDHJE ME POLITIKAT E ARDHSHME NË FUSHËN E ALGOVRIMAVE

Në mënyrë që të sigurojmë përdorim të përgjegjshëm të alGOVritmave dhe të çlirojmë potencialin e plotë të këtyre teknologjive në qeverisje, ne propozojmë masat e mëposhtme:

1 Të themelohet një organ rregullator qeveritar që mbikëqyr zhvillimin, zbatimin dhe përdorimin e alGOVritmave:

Ne propozojmë që të gjitha vendet partnere të vlerësojnë përdorimin e alGOVritmave dhe të fillojnë procesin e krijimit të organeve të brendshme në sistemet e tyre të qeverisjes. Këto njësi publike do duhej të jenë përgjegjëse për të siguruar informacion në kohë, të qasshëm dhe të mjaftueshëm në lidhje me alGOVritma për organet e qeverisjes lokale/kombëtare, mediat, shoqërinë civile, bizneset dhe qytetarët në përgjithësi. E njëjta njësi publike do duhej që gjithashtu të ketë mandat për të monitoruar dhe audituar alGOVritmat ekzistuese dhe për të siguruar raporte vjetore mbi përdorimin e tyre, abuzimet e mundshme dhe rekomandimet e mëtejshme të politikave.

2 Të trajnohen nëpunësit civilë me aftësitë e nevojshme për të monitoruar dhe audituar alGOVritmat në sektorin publik:

Të kemi zyrtarë publikë të trajnuar dhe të aftë është një parakusht për monitorimin dhe auditimin e pavarur dhe shumë të nevojshëm të alGOVritmave. Ne propozojmë një orar trajnimi gjithëpërfshirës, të vazhdueshëm dhe sistematik për punonjësit e zgjedhur të shtetit dhe zyrtarët e zgjedhur publik. Jo të gjithë nëpunësit civilë duhet të përfshihen në këto programe trajnimi. Sidoqoftë, me kalimin e kohës, këto grupe fillestare të vogla mund të zgjerohen, dhe çdo institucion që përdor Teknologji Informatike duhet të ketë të paktën një ekip të vogël me dy persona që kanë kaluar trajnime për alGOVrithms dhe Inteligjencës Artificiale.

3 Të zhvillohet një kornizë ligjore për të drejtuar zhvillimin e alGOVritmave të besueshëm dhe për të rritur transparencën e këtyre teknologjive:

Zhvillimi i një udhëzues të qartë që definon se cilat janë alGOVritma të besueshm, etik dhe transparent kontribuon në rritjen e kuptimit të përgjithshëm të këtyre teknologjive. Prandaj, ky udhëzues mund të shërbejë si një standard i përbashkët për të zhvilluar, mbikëqyrur, monitoruar dhe vlerësuar alGOVritmat e ri. Për më tepër, praktikat transparente të prokurimit të alGOVritmave janë gjithashtu të rëndësishme për të rritur interesin e mediave, shoqërisë civile dhe akademisë për tu përfshirë në procese të ndryshme të monitorimit të këtyre teknologjive, të cilat gjithashtu përfshijnë auditimin e kodit burimor.

4 Të krijohet korniza e nevojshme ligjore dhe të stimulohet shoqëria civile dhe akademja për t'u angazhuar në monitorimin dhe rregullimin e alGOVritmave:

Mungesa e një kornize gjithëpërfshirëse ligjore është pengesë e madhe në udhëzimin e përdorimit të alGOVritmave. Kjo e fundit qartëson procese të ndryshme që lidhen me mbikëqyrjen dhe auditimin e këtyre teknologjive, si dhe hap këtë proces edhe për palët e jashtme të interesuara- përfshirë mediat, OShC-të, akademinë, bizneset dhe qytetarët.

Në të njëjtën kohë, institucionet publike duhet të jenë më të gatshme për të bashkëpunuar dhe stimuluar shoqërinë civile, akademinë dhe mediat për t'u përfshirë në këtë debat. Momentalisht, këto të fundit janë ende duke zhvilluar kapacitetet e nevojshme që lidhen me monitorimin e alGOVritmave. Për këtë arsye, ne propozojmë një program të veçantë të ndërtimit të kapaciteteve që është i hapur për të gjitha palët e interesuara dhe fuqizon aktorë të ndryshëm me aftësi dhe mekanizma të rinjë që sigurojnë përdorim të përgjegjshëm dhe alGOVrithms të besueshme në sektorin publik.

5 Të iniciohen debate publike midis zhvilluesve të politikave, shoqërisë civile, mediave, bizneseve dhe qytetarëve për të krijuar ambientin e nevojshë për zhvillimin alGOVritmave ligjorë që garantojnë parimet e qeverisjes së mirë, të të drejtave të njeriut dhe demokracisë:

Fillimi i një debati të gjerë mbi përdorimin e alGOVritmave dhe inteligjencës artificiale në qeverisje duhet të bëhet prioritetet për të gjitha vendet që dëshirojnë një të ardhme të mirë dhe të sigurtë. Ky studim sygjeron që një publik i mirë-informuar do të ofrojë inpute të çmueshme dhe ide konstruktive se si të formësohet e ardhmja e këtyre teknologjive, në mënyrë që të garantohet qeverisja e mirë, të drejtat e njeriut dhe parimet demokratike.

6 Të krijohet një grup kombëtar i ekspertëve të alGOVritmave dhe inteligjencës artificiale me përfaqësues nga politik-bërësit, shoqëria civile, bizneset dhe akademja. Ky grup të shërbej si organ këshillues qeveritar për iniciativa të ndryshme ku përfshihen alGOVritmat dhe inteligjenca artificiale:

Një organ i përhershëm këshillues i cili përbëhet nga ekspert të alGOVritmatve dhe të inteligjencës artificiale do ta përmisonte të kuptuarit e përgjithshëm të këtyre teknologjive ne sektor të ndryshë të qeverisjes. Prandaj, ky group i eksperteve do të mund t'i shërbente institucioneve të ndryshme (p.sh. Parlamentit, qeverisë etj.) dukei përditësuar me zhvillimet më të fundit të zbatimit të alGOVritmave, inteligjencës artificiale etj.- sidomos kur bëhet fjalë për përdorimin e tyre në një shkallë të gjerë, siç është përdorimi në iniciativa të ndryshme mbarë-kombëtare.

7 Të nxitet pjesa e njohurive dhe shkëmbimit të praktikave të mira midis agjencive qeveritare mbi përdorimin e përgjegjshëm të alGOVrithms:

Deri tash, njohuritë në lidhje me funksionimin dhe përdorimin e alGOVritmave dhe inteligjencës artificiale kanë qenë të kufizuara në agjencitë specifike që i kanë zhvilluar dhe që i përdorin këto teknologji. Ndërsa progresi është shumë i ngadaltë, ritmi me të cilin këto teknologji evoluojnë po rritet gjithnjë e më shumë. Për këtë arsye, ne sugjerojmë që qeveritë të marrin një rol pro-aktiv dhe të stimulojnë praktika të ndryshme të ndarjes së informacionit dhe njohurive. Përderisa kjo krijon praktika të mira dhe të suksesshme, gjithashtu krijon mundësi për të mësuar dhe për të ndarë eksperiencë midis nëpunësve civilë.

8 Të zhvillohen standarde kombëtare për prokurimin, mbikëqyrje dhe auditim të alGOVritmave:

Ne propozojmë që të zhvillohen standarde kombëtare lidhur me prokurimin, shfrytëzimin dhe mbikëqyrjen e alGOVritmave. Këto urdhëresave kombëtare do të shërbenin për të gjitha palët e interesuara (përfshirë palët e interesuara jo-shtetërore, shoqërië civile) si pika të referencës gjatë proceseve të ndryshme të vlerësimit të kostove dhe të auditimit të proceseve publike ku përdoren alGOVritmet dhe inteligjenca artificiale. Një rregullore e tillë do duhej gjithashtu ta bëjë të detyrueshme publikimin e informacionit në lidhje me llojin e të dhënave të cilat përpunohen nga këto alGOVrime, qëllimet e këtyre teknologjike, detyrimet e transparencës të cilat kufizojnë klauzolat e mundshme të sekretit tregtar duke bërë të mundur shpjegimin e plotë të mënyrës se si kjo teknologji do të ndikojë në të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve.

Një standard i tillë do të duhej të ishte mjaft i gjerë dhe të përfshijë të gjitha nivelet e qeverisjes, institucionet dhe agjencitë. Gjithashtu, kjo rregullore nuk duhet të bllokojë apo parandalojë adaptimin e teknologjive në sektorin publik, mirëpo të ofrojë një udhëzues me standarde minimale të cilat duhen të respektohen.

The report has been written and published within the project supported by the International Visegrad Fund (Visegrad Grant No.22020475)

- supported by
- Visegrad Fund
- ●

PROJECT PARTNERS:





OPEN DATA KOSOVO

MARS, 2021